LIGJ
Nr. 76/2026

PËR GRUPIMET EKONOMIKE ME INTERES EVROPIAN[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Themelimi dhe personaliteti juridik i grupimit

1. Grupimet ekonomike me interes evropian formohen sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Personat që synojnë të formojnë një grupim ekonomik me interes evropian duhet të lidhin një kontratë dhe të kryejnë regjistrimin e parashikuar në nenin 6 të këtij ligji.
3. Grupimi i formuar në këtë mënyrë nga data e regjistrimit të tij, siç parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, ka personalitet juridik të ndarë nga anëtarët e tij dhe aftësinë të ketë të drejta dhe detyrime, të lidhë kontrata ose të kryejë aktivitete të tjera ligjore, si dhe të padisë e të paditet.

Neni 2
Ligji i zbatueshëm dhe përkufizime

1. Ligji i zbatueshëm për kontratën për themelimin e grupimit ekonomik me interes evropian, me përjashtim të çështjeve që kanë të bëjnë me statusin juridik ose aftësinë juridike të personave të tyre fizikë (person fizik tregtar ose individin sipas kontekstit) ose juridikë dhe organizimin e brendshëm të grupimit, është ligji shqiptar, nëse adresa zyrtare e grupimit, siç përcaktohet në kontratën e themelimit, ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
a) "**Ligji tregtar**" është ligji shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
b) "**Kontratë**" është kontrata për themelimin e një grupimi ekonomik me interes evropian;
c) "**QKB**" është Qendra Kombëtare e Biznesit;
ç) "**GEIE**" ose "**grupimi**" është një grupim të njohur si grupim ekonomik me interes evropian, i themeluar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
d) "**Shtet anëtar**" është një shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Neni 3
Qëllimi dhe kufizimet e veprimtarisë së grupimit

---

[1] *Ky ligj është përafruar plotësisht me rregulloren e Këshillit të Komunitetit Evropian për grupimin ekonomik evropian të interesit (EEIG), të publikuar me rregulloren KE nr. 2137/85, të 25 korrikut 1985; OJ L 199, 31.7.1985, p. 1–9.*

1. Qëllimi i grupimit është të lehtësojë ose të zhvillojë aktivitetet ekonomike të anëtarëve të tij dhe të përmirësojë ose të rrisë rezultatet e këtyre aktiviteteve. Qëllimi i grupimit nuk është të nxjerrë fitime për veten.

2. Aktiviteti i tij do të lidhet me aktivitetet ekonomike të anëtarëve të tij dhe nuk duhet të jetë më shumë se ndihmës i këtyre aktiviteteve. Rrjedhimisht, grupimi nuk mund:

a) të ushtrojë drejtpërdrejt ose tërthorazi administrimin ose mbikëqyrjen e aktiviteteve të anëtarëve të tij ose aktiviteteve të një shoqërie tjetër, veçanërisht në fushat e personelit, financave dhe investimeve;

b) të zotërojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në çfarëdo baze, aksione të çfarëdolloji në kapitalin e një prej anëtarëve të tij. Pjesëmarrja në shoqëri të tjera si aksionar lejohet vetëm nëse është e nevojshme për realizimin e objektivave të grupimit dhe/ose kryhet në emër dhe për llogari të anëtarëve të tij;

c) të punësojë më shumë se 500 persona;

ç) të përdoret nga një shoqëri për t'i dhënë një hua një administratori të një shoqërie ose çdo personi të lidhur me të;

d) dhe nuk duhet të përdoret për transferimin e pasurisë midis një shoqërie dhe një administratori ose një personi të lidhur me të, përveçse në masën që lejohet nga legjislacioni përkatës i shteteve anëtare. Për qëllimet e kësaj dispozite, dhënia e një huaje përfshin çdo transaksion ose marrëveshje me efekt të ngjashëm dhe pasuria përfshin pasuri të tundshme dhe të patundshme;

dh) të jetë anëtar i grupimit tjetër ekonomik me interes evropian.

3. Për qëllimet e parashikuara në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 2 të këtij neni, dhënia e një huaje përfshin hyrjen në çdo transaksion ose marrëveshje me efekt të ngjashëm dhe prona përfshin pronën e luajtshme e të paluajtshme.

Neni 4

Anëtarët e grupimit dhe kushtet e anëtarësimit

1. Vetëm personat e mëposhtëm mund të jenë anëtarë të grupimit:

a) personat fizikë dhe personat juridikë të së drejtës publike ose private, të cilët janë krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar ose të një shteti anëtar dhe e kanë selinë e tyre të regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar. Kur sipas ligjit të një shteti anëtar një person fizik ose juridik, ose subjekt tjetër juridik nuk është i detyruar të ketë një seli të regjistruar ose statutore, është e mjaftueshme që ai person të ketë administratën e tij qendrore brenda Bashkimit Evropian;

b) personat fizikë që ushtrojnë çdo veprimtari industriale, tregtare, artizanale ose bujqësore apo ofrojnë shërbime profesionale, ose të tjera në Shqipëri ose brenda Bashkimit Evropian.

2. Grupimi duhet të përbëhet të paktën, nga:

a) dy persona fizikë ose juridikë, ose subjekte të tjera juridike në kuptim të pikës 1 të këtij neni, të cilët kanë administratat e tyre qendrore në shtete anëtare dhe në Republikën e Shqipërisë; ose

b) dy persona fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetet e tyre kryesore në shtete anëtare ose në Shqipëri; ose

c) një person juridik dhe një person fizik, prej të cilëve i pari ka administratën e tij qendrore në një shtet anëtar ose në Shqipëri dhe i dyti ushtron aktivitetin e tij kryesor në një shtet tjetër anëtar ose në Shqipëri, me kusht që Shqipëria të mos jetë njëkohësisht vendi i administratës qendrore të personit juridik dhe vendi i aktivitetit kryesor të personit fizik, në kuptim të kësaj pike.

3. Grupimet e regjistruara në QKB, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, nuk duhet të kenë më shumë se 20 anëtarë.

4. Anëtarësia në grupim është personale dhe e pandashme, pa miratimin unanim të anëtarëve të tjerë. Transferimi i të drejtave të anëtarësisë te një person i ri lejohet vetëm me pëlqimin unanim me

shkrim të të gjithë anëtarëve dhe me ndryshimin përkatës të marrëveshjes themeluese, i cili depozitohet pranë QKB-së. Çdo ndryshim në përbërjen e anëtarëve të GEIE-së regjistrohet dhe publikohet, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.

Neni 5
Përmbajtja minimale e kontratës së themelimit

Kontrata për themelimin e grupimit duhet të përfshijë, të paktën:

a) emrin e grupimit të paraprirë ose të ndjekur nga fjalët "Grupim ekonomik me interes evropian" ose nga inicialet "EEIG", përveç nëse këto fjalë ose iniciale janë pjesë të emrit;

b) adresën zyrtare të grupimit;

c) objektivat për të cilët formohet grupimi;

ç) emrin, emrin tregtar, formën juridike, adresën e përhershme ose selinë e regjistruar, numrin dhe vendin e regjistrimit, nëse ka, të çdo anëtari të grupimit;

d) kohëzgjatjen e grupimit, përveç kur kjo është e pacaktuar.

Neni 6
Regjistrimi i grupimit

Grupimi regjistrohet në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, në përputhje me pikën 1, të nenit 38 të këtij ligji.

Neni 7
Dokumentacioni dhe të dhënat që depozitohen në regjistër

Kontrata për themelimin e grupimit depozitohet në regjistrin e përmendur në nenin 6 të këtij ligji. Dokumentet dhe të dhënat e mëposhtme depozitohen në regjistër, si më poshtë:

a) çdo ndryshim në kontratën për themelimin e grupimit, duke përfshirë çdo ndryshim në përbërjen e grupimit;

b) njoftimi për hapjen ose mbylljen e çdo dege të grupimit;

c) vendimi gjyqësor që themelon ose deklaron pavlefshmërinë e grupimit, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;

ç) njoftimi i emërimit të administratorit ose administratorëve të grupimit, emrat e tyre dhe çdo e dhënë tjetër identifikuese që kërkohet nga QKB-ja për regjistrimin e shoqërive tregtare të themeluara, sipas ligjit tregtar. Njoftimi se ata veprojnë vetëm ose bashkërisht dhe përfundimi i çdo emërimi të administratorit;

d) vendimi për miratimin e transferimit të pjesëmarrjes së një anëtari në grupim ose një pjese të tij së bashku me njoftimin përkatës, në përputhje me pikën 1, të nenit 22 të këtij ligji;

dh) çdo vendim i anëtarëve që urdhëron ose nis procedurat e likuidimit të grupimit, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, ose çdo vendim gjyqësor që urdhëron likuidimin në përputhje me nenin 31 ose 32 të këtij ligji;

e) njoftimi i emërimit të likuidatorit ose likuidatorëve të grupimit, siç referohet në nenin 35 të këtij ligji, emrat e tyre dhe çdo e dhënë tjetër identifikuese, në përputhje me kërkesat e QKB-së për likuidatorët e caktuar për shoqëritë tregtare të organizuara, sipas ligjit tregtar, dhe përfundimi i detyrës së likuidatorit;

ë) njoftimi i përfundimit të likuidimit të grupimit, siç referohet në nenin 35 të këtij ligji;

f) çdo propozim për transferimin e adresës zyrtare, siç referohet në pikën 1, të nenit 14 të këtij ligji;

g) çdo dispozitë që përjashton një anëtar të ri nga pagesa e detyrimeve të tjera që kanë lindur para pranimit të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji.

Neni 8

Publikimi i dokumenteve dhe të dhënave në regjistër

Të dhënat e mëposhtme duhet të publikohen, siç përcaktohet në nenin përkatës të këtij ligji, në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, si më poshtë:

a) të dhënat që duhet të përfshihen në kontratën për themelimin e grupimit, në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji, dhe çdo ndryshim i tyre;

b) numri, data dhe vendi i regjistrimit, si dhe njoftimi i përfundimit të atij regjistrimi;

c) dokumentet dhe të dhënat e parashikuara nga shkronja "b" deri në shkronjën "g", të nenit 7 të këtij ligji.

Të gjitha të dhënat që përmenden në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni duhet të publikohen në formën e tyre të plotë në regjistrin tregtar. Dokumentet dhe të dhënat që përmenden në shkronjën "c" të këtij neni duhet të publikohen ose në formë të plotë, ose si pjesë përbërëse e ekstraktit tregtar të grupimit.

Neni 9

Certifikimi i regjistrimit dhe veprimet paraprake

1. Dokumentet dhe të dhënat që duhet të publikohen në përputhje me këtë ligj mund të përdoren nga grupimi kundrejt palëve të treta, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji kombëtar i zbatueshëm. Me regjistrimin e grupimit, QKB-ja lëshon ekstraktin tregtar që vërteton se GEIE-ja është regjistruar.

2. Ekstrakti tregtar përbën provë përfundimtare se kërkesat e këtij ligji lidhur me regjistrimin, si dhe çështjet paraprake dhe të ndërlidhura me të, janë përmbushur, dhe se grupimi është një organizim i autorizuar për t'u regjistruar dhe është regjistruar në përputhje me këtë ligj.

3. Nëse aktivitetet janë kryer në emër të grupimit para regjistrimit të tij, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe nëse grupimi nuk merr përsipër pas regjistrimit të tij detyrimet që rrjedhin nga aktivitete të tilla, personat fizikë, shoqëritë, firmat ose çdo person fizik ose juridik, që kanë kryer këto aktivitete, do të mbajnë përgjegjësi të pakufizuar solidare për to.

Neni 10

Regjistrimi i degëve në shtete anëtare

Çdo degë e grupimit, e vendosur në një shtet anëtar, do të regjistrohet në atë shtet.

Për qëllimin e këtij regjistrimi, grupimi do të depozitojë në regjistrin përkatës në atë shtet anëtar kopje të dokumenteve që duhet të depozitohen në QKB së bashku, nëse është e nevojshme, me një përkthim, që përputhet me praktikën e regjistrit ku është regjistruar dega.

Neni 11

Njoftimi në gazetën zyrtare të komuniteteve evropiane

Njoftimi se grupimi është formuar ose se likuidimi i grupimit është përfunduar, duke deklaruar numrin, datën dhe vendin e regjistrimit dhe datën, vendin dhe titullin e publikimit, do të jepet në gazetën zyrtare të BE-së, pasi të jetë publikuar në QKB, sipas nenit 40 të këtij ligji.

Neni 12

Adresa zyrtare e grupimit

Adresa zyrtare e përmendur në kontratën për formimin e një grupimi duhet të jetë e vendosur brenda Bashkimit Evropian dhe/ose Shqipërisë.

Adresa zyrtare duhet të jetë e caktuar në njërën nga këto vende:

a) aty ku grupimi ka administratën e tij qendrore; ose

b) aty ku njëri prej anëtarëve të grupimit ka administratën e tij qendrore ose, në rastin e një personi fizik, aty ku zhvillon aktivitetin e tij kryesor, me kusht që grupimi të kryejë një aktivitet në atë vend.

Neni 13

Transferimi i adresës zyrtare të grupimit

Adresa zyrtare e grupimit mund të transferohet nga një vend në një tjetër brenda komunitetit. Nëse ky transferim nuk sjell ndryshim të ligjit të zbatueshëm për grupimin, në kuptim të nenit 2 të këtij ligji, atëherë vendimi për transferimin e adresës merret në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratën e themelimit të grupimit. Në të gjitha rastet e tjera, kur si rezultat i transferimit ndryshon ligji i zbatueshëm, zbatohen procedurat e veçanta të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 14

Transferimi i adresës zyrtare kur ndryshon ligji i zbatueshëm

1. Kur transferimi i adresës zyrtare sjell ndryshime në ligjin e zbatueshëm, sipas përcaktimeve në nenin 2 të këtij ligji, propozimi për transferim duhet të hartohet, të depozitohet dhe të publikohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Asnjë vendim për transferim nuk mund të merret për 2 muaj pas publikimit të propozimit. Çdo vendim i tillë duhet të merret unanimisht nga anëtarët e grupimit. Transferimi hyn në fuqi në datën në të cilën grupimi regjistrohet, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, në regjistrin për adresën e re zyrtare. Ky regjistrim nuk mund të kryhet derisa të jetë paraqitur prova se propozimi për transferimin e adresës zyrtare është publikuar.

2. Përfundimi i regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e tij të vjetër zyrtare nuk mund të kryhet para se të jetë paraqitur prova e regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e re zyrtare.

3. Pas publikimit të regjistrimit të ri të grupimit, adresa e re zyrtare mund t'u bëhet e ditur palëve të treta, në përputhje me kushtet e referuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji, megjithatë, për sa kohë përfundimi i regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e vjetër zyrtare nuk është publikuar, palët e treta mund të vazhdojnë të mbështeten në adresën e vjetër zyrtare, përveçse kur grupimi provon se palët e treta ishin në dijeni të adresës së re zyrtare.

Neni 15

Pavlefshmëria e grupimit

1. Një grupim mund të shpallet i pavlefshëm vetëm me vendim gjykate. Gjykata të cilës i drejtohet çështja, aty ku është e mundur që punët e grupimit të rregullohen, të japë kohë për të bërë këtë.

2. Pavlefshmëria e grupimit bazohet vetëm:

a) në shkeljen e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 4 të këtij ligji;

b) kur qëllimi i grupimit është i paligjshëm ose bie ndesh me rendin publik.

3. Pavlefshmëria e grupimit sjell likuidimin e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.

4. Një vendim që themelon ose deklaron pavlefshmërinë e grupimit mund t'u drejtohet palëve të treta, në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 9 të këtij ligji. Ky vendim nuk ndikon në vlefshmërinë e detyrimeve të pagueshme nga ose ndaj grupimit, të cilat kanë lindur para momentit kur vendimi mund të ketë efekt ndaj palëve të treta.

Neni 16

Organet e grupimit

1. Organet e grupimit janë:

a) anëtarët të cilët veprojnë kolektivisht dhe ushtrojnë kompetencat vendimmarrëse, të përcaktuara në këtë ligj dhe në kontratën për themelimin e grupimit;

b) administratori ose administratorët të cilët ushtrojnë funksionet ekzekutive e të përfaqësimit, në përputhje me këtë ligj dhe me kontratën e themelimit.

2. Kontrata për themelimin e grupimit mund të parashikojë edhe krijimin e organeve të tjera shtesë, për qëllime këshillimore ose mbikëqyrëse, duke përcaktuar qartë përbërjen e tyre, mënyrën e emërimit të anëtarëve të tyre, kompetencat dhe fushëveprimin e tyre, dhe raportet me organet e tjera të grupimit.

3. Kompetencat e secilit organ caktohen në përputhje me këtë ligj dhe me kontratën për themelimin e grupimit pa cenuar dispozitat e kapitujve të veçantë për administrimin dhe përfaqësimin e grupimit.

4. Anëtarët e grupimit, duke vepruar si një organ, mund të marrin çdo vendim të ligjshëm për qëllimin e arritjes së objektivave të grupimit.

Neni 17

Të drejtat e votës dhe vendimmarrja e anëtarëve

1. Çdo anëtar ka një votë. Kontrata për themelimin e grupimit mund t'u japë më shumë se një votë disa anëtarëve, me kusht që asnjë anëtar të mos mbajë shumicën e votave.

2. Vendimi unanim i anëtarëve është i nevojshëm:

a) për të ndryshuar objektivat e grupimit;

b) për të ndryshuar numrin e votave të caktuara për çdo anëtar;

c) për të ndryshuar kushtet për marrjen e vendimeve;

ç) për të zgjatur kohëzgjatjen e grupimit përtej çdo periudhe të fiksuar në kontratën për themelimin e grupimit;

d) për të ndryshuar kontributin e çdo anëtari ose të disa anëtarëve në financimin e grupimit;

dh) për të ndryshuar çdo detyrim tjetër të anëtarit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata për themelimin e grupimit;

e) për të bërë çdo ndryshim në kontratën për themelimin e grupimit që nuk parashikohet në këtë pikë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ajo kontratë.

3. Përveçse kur ky ligj parashikon që vendimet duhet të merren unanimisht, kontrata për themelimin e grupimit mund të përcaktojë kushtet për kuorumin dhe për shumicën, në përputhje me të cilat do të merren vendimet, ose disa prej tyre. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata, vendimet do të merren unanimisht.

4. Me iniciativën e një administratori ose me kërkesë të një anëtari, administratorët organizojnë një mbledhje në të cilën anëtarët konsultohen paraprakisht për çështje të caktuara, në mënyrë që të mund të marrin një vendim.

Neni 18
E drejta e anëtarëve për informim dhe inspektim

Çdo anëtar ka të drejtë të marrë informacion nga administratorët për ecurinë tregtare të grupimit dhe të inspektojë librat dhe regjistrat e biznesit të grupimit.

Neni 19
Administratorët e grupimit, emërimi dhe kompetencat

1. Grupimi administrohet nga një ose më shumë persona fizikë të emëruar në kontratën për themelimin e grupimit ose me vendim të anëtarëve. Asnjë person nuk mund të jetë administrator i grupimit nëse, pas një vendimi gjyqësor ose administrativ të marrë, ose të njohur në Shqipëri ose një shtet anëtar, administratori nuk mund të bëjë pjesë në organin administrativ, ose drejtues të një shoqërie tregtare ose nuk mund të veprojë si administrator i GEIE-së.
2. Kontrata për themelimin e grupimit ose, në mungesë të saj, një vendim unanim i anëtarëve përcakton kushtet për emërimin dhe shkarkimin e administratorit, ose administratorëve dhe kompetencat e tyre.

Neni 20
Përfaqësimi i grupimit dhe kompetencat e administratorëve

1. Përfaqësimin e grupimit me palë të treta e kanë vetëm administratori ose administratorët kur janë dy ose më shumë.
2. Grupimi mbetet i detyruar nga këto veprime edhe nëse ato nuk janë në përputhje me objektivat e tij, përveçse në rastet kur grupimi provon se pala e tretë ka pasur dijeni për mospërputhjen ose, në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni. Publikimi i të dhënave, të referuara në shkronjën "c" të nenit 5 të këtij ligji, nuk do të jetë në vetvete provë për këtë. Asnjë kufizim në kompetencat e administratorëve, pavarësisht nëse buron nga kontrata e themelimit të grupimit apo nga një vendim i anëtarëve, nuk mund t'u drejtohet palëve të treta, edhe nëse është publikuar.
3. Kontrata për themelimin e grupimit mund të parashikojë që grupimi të përfaqësohet vetëm nga dy ose më shumë administratorë që veprojnë bashkërisht. Një klauzolë e tillë mund t'u drejtohet palëve të treta vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji dhe vetëm nëse është publikuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

Neni 21
Pjesëmarrja në fitime dhe humbje

1. Fitimet që rezultojnë nga aktivitetet e grupimit do të konsiderohen si fitime të anëtarëve dhe do të ndahen mes tyre në proporcionet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të ndonjë dispozite të tillë, në pjesë të barabarta.
2. Anëtarët e grupimit do të kontribuojnë në pagesën e shumës me të cilën shpenzimet tejkalojnë të ardhurat në proporcionet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të ndonjë dispozite të tillë, në pjesë të barabarta.

Neni 22

Transferimi i pjesëmarrjes së anëtarit dhe përdorimi i saj si garanci

1. Çdo anëtar i grupimit mund të transferojë pjesëmarrjen e tij në grupim, në tërësi ose për një pjesë të saj (në kuptimin e një përqindjeje të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga cilësia e anëtarit), te një anëtar tjetër ose një palë e tretë, me kusht që ky transferim të miratohet unanimisht nga të gjithë anëtarët e tjerë.

2. Anëtari i grupimit mund të përdorë pjesëmarrjen e tij si garanci vetëm nëse të gjithë anëtarët e tjerë japin miratim unanim, përveçse kur kontrata e themelimit parashikon ndryshe. Marrësi i garancisë nuk mund të fitojë statusin e anëtarit të grupimit vetëm në bazë të kësaj garancie, pa kaluar procedurën e pranimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në kontratën e grupimit.

Neni 23

Ndalimi i mbledhjes së investimeve nga publiku

Grupimi nuk mund të mbledhë apo të marrë investime nga publiku.

Neni 24

Përgjegjësia e anëtarëve për detyrimet e grupimit

1. Anëtarët e grupimit kanë përgjegjësi të pakufizuar dhe solidare për detyrimet e grupimit, të çfarëdo natyre qofshin ato.

2. Çdo dispozitë në kontratën e themelimit të grupimit që përpiqet të përjashtojë ose të kufizojë përgjegjësinë e përmendur në pikën 1 të këtij neni është e pavlefshme.

3. Kreditorët nuk mund të kërkojnë ekzekutimin e detyrimeve të grupimit ndaj anëtarit, përveçse në rastet kur fillimisht i kanë kërkuar pagesën grupimit dhe pagesa nuk është bërë brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se 3 muaj.

Neni 25

Të dhënat e detyrueshme në dokumentet zyrtare të grupimit

1. Çdo shkresë apo dokument zyrtar i grupimit duhet të përmbajë:

a) emrin e grupimit të paraprirë ose të ndjekur apo nga fjalët "Grupim ekonomik me interes evropian" ose nga inicialet "GEIE", përveçse kur këto fjalë ose iniciale tashmë gjenden në emër;

b) vendndodhjen e regjistrimit, të referuar në nenin 6 të këtij ligji, në të cilin është regjistruar grupimi, së bashku me numrin unik të identifikimit në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja;

c) adresën zyrtare të grupimit;

ç) kur është e zbatueshme, shënimin se administratorët veprojnë bashkërisht;

d) kur është e zbatueshme, shënimin se grupimi është në likuidim, në përputhje me nenet 15, 31, 32 ose 36 të këtij ligji.

2. Çdo degë e grupimit, kur regjistrohet në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, duhet të japë të dhënat e mësipërme së bashku me ato që lidhen me regjistrimin e saj në dokumentet e referuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 26

Pranimi i anëtarëve të rinj dhe përgjegjësia e tyre

1. Vendimi për pranimin e anëtarëve të rinj merret unanimisht nga anëtarët e grupimit.

2. Çdo anëtar i ri është përgjegjës, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji, për të gjitha detyrimet e grupimit, përfshirë ato që kanë lindur përpara pranimit të tij. Ai përjashtohet nga kjo përgjegjësi nëse një përjashtim i tillë parashikohet në kontratën për themelimin e grupimit ose në aktin e pranimit të tij si anëtar vetëm për detyrime që rrjedhin para anëtarësimit të tij. Ky përjashtim ka efekt ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 27

Tërheqja dhe përjashtimi i anëtarëve

1. Anëtari i grupimit mund të tërhiqet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të kushteve të tilla, me miratimin unanim të anëtarëve të tjerë. Anëtari i grupimit mund të tërhiqet, gjithashtu, nëse grupimi apo anëtarët e tjerë kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse grupimi i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e anëtarësisë. Anëtari që kërkon largimin duhet të njoftojë grupimin me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

2. Çdo anëtar i grupimit mund të përjashtohet për arsyet e listuara në kontratën për themelimin e grupimit.

3. Përveç sa është parashikuar në pikën 2 të këtij neni, me vendim unanim të marrë nga anëtarët e grupimit, në përputhje me kontratën e themelimit, grupimi mund të vendosë t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e një anëtari, nëse ai ka dështuar të përmbushë kontributin e tij financiar ose kontribut tjetër, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për përjashtimin. Për qëllime të kësaj pike, përbëjnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin, kur:

a) anëtari, me dashje ose pakujdesi të rëndë, i shkakton dëme grupimit ose anëtarëve të tjerë;

b) anëtari përfshihet në sjellje që e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda grupimit;

c) veprimet ose mosveprimet e anëtarit pengojnë ndjeshëm funksionimin ose objektivat e përbashkët të grupimit.

Neni 28

Përfundimi i anëtarësisë

1. Statusi i anëtarit në grupim përfundon, kur:

a) anëtari është person fizik dhe ndërron jetë;

b) anëtari është person juridik dhe ai shpërbëhet, likuidohet ose çregjistrohet nga regjistri përkatës;

c) anëtari nuk i përmbush më kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 4 të këtij ligji.

2. Në rast vdekjeje të një personi fizik që është anëtar i grupimit, askush nuk mund të bëhet anëtar në vend të tij, përveçse sipas kushteve të përcaktuara në kontratën për formimin e grupimit ose, në mungesë të saj, me pëlqimin unanim të anëtarëve të mbetur.

Neni 29

Njoftimi dhe veprimet pas largimit të një anëtari

Sapo një anëtar pushon së qeni pjesë e grupimit, administratorët duhet të informojnë anëtarët e tjerë për këtë fakt, si dhe të ndërmarrin hapat e kërkuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Përveç administratorëve, çdo person i interesuar mund të ndërmarrë këta hapa.

Neni 30

Vazhdimi i grupimit pas largimit të një anëtari

Përveçse kur kontrata për themelimin e grupimit parashikon ndryshe dhe pa cenuar të drejtat e fituara nga një person, sipas pikës 1, të nenit 22 të këtij ligji ose pikës 2, të nenit 28 të këtij ligji, grupimi do të vazhdojë të ekzistojë për anëtarët e mbetur, pasi anëtari i larguar të ketë pushuar së qeni pjesë e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose të përcaktuara me vendim unanim të anëtarëve në fjalë.

Neni 31

Mbyllja e grupimit me vendim të anëtarëve

1. Grupimi mund të mbyllet me vendim të anëtarëve të tij, me kusht që ky vendim të merret unanimisht, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratën për themelimin e grupimit.

2. Grupimi duhet të mbyllet me vendim të anëtarëve të tij, kur:

a) ka përfunduar kohëzgjatja e grupimit, e parashikuar në kontratën për themelimin e grupimit ose kur ekziston ndonjë shkak tjetër për mbyllje të parashikuar në kontratë; ose

b) është përmbushur qëllimi i grupimit ose është e pamundur të ndiqet më tej ky qëllim. Në rast se 3 muaj pasi ka ndodhur një nga situatat e referuara në këtë pikë vendimi i anëtarëve për mbylljen e grupimit nuk është marrë, çdo anëtar mund t'i drejtohet gjykatës për të urdhëruar mbylljen.

3. Grupimi mbyllet me vendim të anëtarëve të tij ose të anëtarit të mbetur, kur kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 4 të këtij ligji nuk mund përmbushen më.

4. Pasi grupimi të jetë mbyllur me vendim të anëtarëve të tij, administratorët duhet të ndërmarrin hapat e kërkuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Përveç administratorëve, çdo person i interesuar mund të ndërmarrë këta hapa.

Neni 32

Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve të anëtarit që largohet

Kur një anëtar pushon së qeni pjesë e grupimit për çfarëdo arsye tjetër, përveç transferimit të të drejtave të tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 22 të këtij ligji, vlera e të drejtave dhe detyrimeve të tij përcaktohet duke marrë parasysh aktivet dhe pasivet e grupimit në datën kur ai pushon së qeni pjesë e tij. Vlera e të drejtave dhe detyrimeve të anëtarit që largohet nuk mund të përcaktohen paraprakisht.

Neni 33

Përgjegjësia e anëtarit të larguar për detyrimet e mëparshme

Pa cenuar pikën 1, të nenit 37 të këtij ligji, çdo anëtar që pushon së qeni pjesë e grupimit do të mbetet përgjegjës, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, për detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e grupimit para se ai të pushonte së qeni anëtar.

Neni 34

Likuidimi i grupimit

1. Mbyllja e grupimit sjell likuidimin e tij.
2. Likuidimi i grupimit dhe përfundimi i likuidimit të tij do të rregullohen sipas dispozitave të zbatueshme për likuidimin e shoqërive kolektive.
3. Grupimi do të ruajë aftësinë e tij, në kuptimin e pikës 2, të nenit 1 të këtij ligji, derisa të përfundojë likuidimi i tij.
4. Likuidatori ose likuidatorët do të ndërmarrin hapat e parashikuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 35
Likuidimi vullnetar dhe falimentimi i grupimit

Grupimet do t'u nënshtrohen ligjeve shqiptare që rregullojnë likuidimin vullnetar, falimentimin dhe pagesat e vonuara. Fillimi i procedurave kundër grupimit për arsye të falimentimit ose rikuperimit të pagesave nuk do të shkaktojë vetvetiu fillimin e procedurave të tilla kundër anëtarëve të tij.

Neni 36
Afatet e parashkrimit për kërkesat ndaj ish-anëtarëve

1. Një afat parashkrimi prej 5 vjetësh nga data e publikimit, sipas nenit 8 të këtij ligji, të njoftimit të largimit të anëtarit nga grupimi prevalon ndaj çdo afati më të gjatë, të parashikuar në ligjin shqiptar, për veprimet gjyqësore kundër këtij anëtari, që lidhen me borxhe dhe detyrime të lindura përpara largimit të tij.
2. Një afat 5-vjeçar nga data e publikimit të përfundimit të likuidimit të grupimit zëvendëson çdo afat më të gjatë për ndjekje të veprimeve ndaj një anëtari për detyrime të lindura gjatë ekzistencës së grupimit.

Neni 37
Masat administrative për shkeljet e ligjit

1. Nëse grupimi zhvillon veprimtari në kundërshtim me këtë ligj, ministria përgjegjëse për ekonominë, vetë ose nëpërmjet ndonjë agjencie të autorizuar prej saj, mund të ushtrojë të drejtën për t'i kërkuar gjykatës mbylljen e grupimit, sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj. Për shkelje të kërkesave administrative të parashikuara në këtë ligj zbatohen sanksionet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e bizneseve.
2. Grupimi dhe anëtarët e tij kanë të drejtë të bëjnë ankim ndaj vendimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 38
Regjistri, rregullat e regjistrimit dhe sanksionet

1. QKB-ja do të jetë institucioni përgjegjës për kryerjen e regjistrimit të referuar në nenet 6 dhe 10 të këtij ligji.
2. Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton rregullat e posaçme për regjistrimin e grupimeve në regjistrin tregtar të QKB-së, duke përcaktuar kushtet dhe mënyrën e depozitimit të dokumenteve të referuara në nenet 7 dhe 10 të këtij ligji. Rregullat duhet të sigurojnë që dokumentet dhe të dhënat

e referuara në nenin 8 të këtij ligji të publikohen në QKB, duke parashikuar mënyrën e publikimit të dokumenteve dhe të dhënave të referuara në shkronjën "c", të nenit 8 të këtij ligji. Të dhënat e regjistrit tregtar për grupimet aksesohen lirisht nga cilido, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji ose, kur është e përshtatshme, me nenin 10 të këtij ligji.

3. Informacioni që publikohet në gazetën zyrtare të komuniteteve evropiane, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, duhet t'i përcillet zyrës për publikime zyrtare të komuniteteve evropiane brenda një muaji nga publikimi i tij në QKB.

4. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve për depozitimin ose publikimin e dokumenteve, sipas neneve 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, çdo person juridik ose fizik, përgjegjës për grupimin, do të gjobitet nga QKB-ja në vlerën 50 000 deri në 200 000 lekë për çdo shkelje. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara në nenin 25 të këtij ligji për përfshirjen e të dhënave në dokumentet zyrtare të grupimit, gjoba do të jetë nga 30 000 deri në 100 000 lekë.

5. Për shkelje të përsëritura ose të qëllimshme, masat shtesë, përfshirë pezullimin e regjistrimit ose kërkesën për shpërbërjen e grupimit, mund të vendosen vetëm nëpërmjet gjykatës.

Neni 39

Tatimi

1. Fitimet ose humbjet që rezultojnë nga veprimtaria e grupimit do të konsiderohen si të lindura drejtpërdrejt për anëtarët të tij dhe do të jenë objekt tatimi drejtpërdrejt për ta, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

2. Në rastet kur anëtari është subjekt jorezident, grupimi vepron si agjent i mbajtjes në burim të tatimit mbi pjesën e fitimit që i takon këtij anëtari, përveçse kur vërtetohet se tatimi është paguar rregullisht në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian për atë vit fiskal.

3. Në rast se tatimi mbahet në burim nga grupimi dhe më pas anëtari paraqet dokumentacionin provues, ai ka të drejtën e rimbursimit ose kreditimit të tatimit të paguar sipas procedurave të parashikuara në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 40

Njoftimi i Komisionit Evropian për kategoritë e personave të ndaluar të marrin pjesë në grupime

QKB-ja do të informojë Komisionin Evropian për kategoritë e personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është ndaluar pjesëmarrja në grupime, në përputhje me pikën 4, të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 41

Aktet nënligjore dhe afatet për zbatimin e ligjit

1. Procedurat e hollësishme për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punës dhe atij të statistikave, si dhe miratimi i procedurës së lëshimit të numrit unik të identifikimit të grupimeve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe financën, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton udhëzimin për formën dhe përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKB-ja dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer, sipas këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të miratojë procedurat e hollësishme për hedhjen dhe formën e hedhjes, si dhe shfaqjen në regjistër të grupimeve, sipas përcaktimeve në ligjin për regjistrimin e biznesit dhe të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 42
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 461, datë 31.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.